



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR PUNONJËS POLICIE NË
DREJTORINË E POLICISË BASHKIAKE**

Në zbatim të ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, neni 12,13,14 si edhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullorës kuadër të Policisë Bashkiake”, kreu III “Rregullat dhe Procedurat e detajuara të pranimit në Policinë Bashkiake”, Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Berat Nr. 857, datë 06.12.2024 “Mbi miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2025”, “Për miratimin e strukturës së Drejtorisë së Policisë Bashkiake”, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Berat njofton se në Drejtorinë e Policisë Bashkiake shpallen vende të lira pune:

- **2 (dy) Punonjës të Policisë Bashkiake, në Drejtorinë e Policisë Bashkiake, Bashkia Berat**

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE DO TË JETË

17.02.2024

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E POLICISË BASHKIAKE

1. Policia Bashkiake ka këto kompetenca dhe detyra, në përputhje edhe me aktet e tjera rregullatore:

- siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak;
- parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative përmes forcimit, inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj.

2. Në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, Policia Bashkiake:

- merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
- kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
- vendos kufizimin e qarkullimit në rrugë jashtë qendrave të banuara për ditët e festave lokale në bashkëpunim me organet e Policisë Rrugore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

ç) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të saj;

d) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të bashkisë;

dh) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë;

e) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të bashkisë;

ë) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;

f) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;

g) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.

3. Në fushën e bashkëjetesës shoqërore, Policia Bashkiake:

a) mbikëqyr respektimin e normave etike detyruese të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

b) mbështet organet e inspektimit për zbatimin e legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

c) siguron ekzekutimin e sanksioneve për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesave sociale me qira dhe kufizimet mbi banesat me kosto të ulët, të vendosura nga entet menaxhuese.

4. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Policia Bashkiake:

a) bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;

b) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të kontrollit mbi gjuetinë kur pengohen në kryerjen e detyrës;

c) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të inspektimit që mbulojnë veprimtarinë e peshkimit;

ç) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e liqeneve ndërkuftare, brigjeve të tyre, zonave ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to;

d) verifikon dhe kontrollon zbatimin e kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat.

5. Në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe tregtare, Policia Bashkiake:

a) siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;

b) verifikon respektimin e normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje apo vende të autorizuar nga bashkia të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme dhe vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve;

c) mbështet strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtarinë e tyre.

6. Në fushën e mbrojtjes së shëndetit, Policia Bashkiake siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë dhe mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme.

7. Në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, Policia Bashkiake:

a) siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

b) vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;

c) siguron zbatimin e rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;

ç) garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

1.1

KRITERET PËR PRANIM NË POLICINË BASHKIAKE

KRITERET E PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN NË POLICINË BASHKIAKE JANË SI MË POSHTË:

1. të jetë shtetas shqiptar;
2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
4. të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;
5. të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
6. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
7. të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
8. të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj Diplomë/Dëftese Pjekurie e arsimit të mesëm të lartë sipas legjislacionit të arsimit Parauniversitar
- b) *(Diplomat/ dëftesat/certifikatat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- d) Të ketë figurë të pastër morale.

FAZAT E KONKURIMIT

Pranimi në Policinë Bashkiake bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e kriterëve dhe aftësive profesionale të kandidatëve.

Pranimi kryhet nëpërmjet një konkurimi të hapur përmes një procesi përzgjedhës dhe testimi transparent e të drejtë. Fazat e konkurimit do të jenë përkatësisht:

- testimi me shkrim
- testimi fizik
- intervista

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët brenda datës **17.02.2024** duhet të paraqesin pranë zyrës së protokollit të Bashkisë Berat ose pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm :

1. kërkesën;
2. jetëshkrimin;
3. fotokopjen e kartës së identitetit;
4. fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm të lartë;
5. 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;
6. raportin e aftësisë në punë /mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;
7. certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
8. vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
9. vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
10. dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës;
11. vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
12. vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

13. vërtetimin që të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
14. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e përkatëse (nëse ka);
15. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “B”;
16. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore shtetërore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
17. Vërtetim vendbanimi.
18. Vërtetim nga Tatim Taksat që nuk ka biznes në territorin e bashkisë Berat.

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit me kërkesën e bashkisë përkatëse, përpara pranimit në Policinë Bashkiake duhet të merret edhe vërtetimi i besueshmërisë që lëshohet nga struktura vendore e Policisë së Shtetit. Dokumenti do t’u bashkangjitet dokumentave të dorëzuara nga kandidatët dhe do t’u vihet në dispozicion komisionit përzgjedhës.

1.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në përfundim të afatit të verifikimit paraparak nga Komisioni Përzgjedhës, Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, Bashkia Berat, do të shpallë në faqjen zyrtare të Bashkisë Berat dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe kandidatët do të njoftohen për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave rast pas rasti.

Në të njëjtën kohë, kandidatët e skualifikuar, do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për arsyet e moskualifikimit nëpërmjet adresës së tyre të e-mailit. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Berat. Afati i ankimimit është 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

1.4

FUSHA KRYESORE MBI TË CILËN BAZOHET KONKURIMI

- Njohuritë mbi ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikën e Shqipërisë
- Njohuritë mbi ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullorës kuadër të Policisë Bashkiake”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

1.5

MËNYRA E VLERESIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për këto faza të konkurimit:

➤ **Testim me shkrim deri në 60 pikë**

1. Testimi me shkrim kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e listës së kandidatëve, që plotësojnë kriteret ligjore për t'u pranuar në Policinë Bashkiake. Më shumë detaje në lidhje me mënyrën e zhvillimit të testimit i gjeni në kreu III "Rregullat dhe Procedurat e detajuara të pranimit në Policinë Bashkiake" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullorës kuadër të Policisë Bashkiake".

Kandidati nuk kualifikohet për vazhdimin e konkurrimit nëse nuk merr 60% të pikëve të përcaktuara.

Kandidati që merr më shumë 60% të pikëve të përcaktuara të testimit do të do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit.

➤ **Testim i aftësive fizike;**

Në këtë fazë konkurrimi, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, Kandidatët që kalojnë testimin me shkrim i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, i cili teston aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

Përmbajtja e testimit të aftësive fizike dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve përgatiten nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

Kandidati quhet fitues kur ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin e aftësive fizike.

Kandidatët fitues renditen sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm dhe njoftohen për intervistën.

➤ **Intervista me gojë**

Intervista konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

Në këtë fazë konkurrimi, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;

b) intervista, deri në 10 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me mënyrën e zhvillimit të testimit i gjeni në kreu III "Rregullat dhe Procedurat e detajuara të pranimit në Policinë Bashkiake" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullorës kuadër të Policisë Bashkiake".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim, testimit fizik dhe rezultatit të intervistës me gojë.

Kandidati që merr më shumë se 60 pikë për të treja fazat konsiderohet i suksesshëm .

Kandidatët, që kanë marrë më pak se 60 pikë, renditen në një listë të posaçme që nuk bëhet publike dhe ata njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore.

Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Komisioni përzgjedhës dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Berat . Afati i ankimit është 5 ditë nga data e njoftimit dhe do të marin përgjigje zyrtare brenda 5 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të ankimit.

Kandidati që merr më pak se 60 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

| | |
|------------|--|
| 1.6 | DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT |
|------------|--|

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve për të treja fazat e konkurimit, raportit dhe vendimit nga komisioni përzgjedhës si edhe përfundimit të fazës së ankimit, Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, Bashkia Berat, do të shpallë fituesit në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

BASHKIA BERAT